

Zbulimi & Paralajmërimet e rrezikut

Tregtimi i produkteve dhe shërbimeve të BKT Smart-Invest mund të rezultojë në humbje si dhe fitime. Në veçanti tregtimi me produkte të caktuara financiare siq është, por jo i kufizuar në këmbimin e huaj, derivativave dhe mallrat mund të jenë shumë spekulative dhe humbjet dhe fitimet mund të luhaten në mënyrë të dhunshme dhe të shpejtë. Tregtia spekulative nuk është e përshtatshme për të gjithë investitorët.

Tregtimi ne produkte financiare gjithmonë përfshin një rrezik. Si rregull i përgjithshëm, ju duhet të bëni tregtim vetëm me produkte financiare nese i kuptoni produktet dhe rreziqet që lidhen me to.

Çdo shfaqje e tyre , nëse ka, në një publikim të rreziqeve që i përkasin një produkti ose shërbimi të caktuar nuk mund dhe nuk duhet të interpretohet si një zbulim gjithëpërfshirës ose përshkrim i plotë i të gjitha rreziqeve që i përkasin një produkti ose shërbimi të tillë dhe BKT inkurajon fuqimisht çdo marrës që konsideron tregtimin në produktet dhe shërbimet e tij të angazhoj dhe konsultoj vazhdimisht këshilltarë të përshtatshëm financiarë përpara konkluzionit për ndonjë investim ose transaksion.

Klienti deklaron se ai/ajo ka lexuar, kuptuar dhe pa kushte pranon si vijon se:

- a) Informacioni mbi performancën e mëparshme të një Instrumenti Financiar dhe Kontratat përkatëse, nuk garanton performancën e tij aktuale, dhe/ose të ardhshme. Përdorimi i të dhënave historike nuk përbën një parashikim të detyrueshëm ose të sigurt për sa i përket performancës përkatëse të ardhshme të Instrumenteve Financiare të cilave u referohet informacioni në fjalë.
- b) Disa Instrumente Financiare nuk mund të bëhen menjëherë likuide si rezultat p.sh. të kërkesës së zvogëluar dhe Klienti mund të mos jetë në gjendje t'i shesë ato ose të marrë lehtësisht informacion mbi vlerën e këtyre Instrumenteve Financiare ose shtrirjen e rreziqeve të shoqëruara me to.
- c) Kur një Instrument Financiar tregtohet në një valute tjetër përveç valutes së vendit të banimit të Klientit, çdo ndryshim në kurset e këmbimit mund të ketë një efekt negativ në vlerën, çmimin dhe performancën e tij.
- d) Një Instrument Financiar në tregjet e huaja mund të sjellë rreziqe të ndryshme nga rreziqet e zakonshme të tregjeve në vendin e banimit të Klientit. Në disa raste, këto rreziqe mund të jenë më të mëdha. Perspektiva e fitimit ose humbjes nga transaksionet në tregjet e huaja ndikohet gjithashtu nga luhajtjet e kursit të këmbimit.
- e) Instrumentet financiare të ofruara nga platforma Smart-Invest e BKT janë një transaksion jo-shpërndarës dhe Kontrata e CFD ofron një mundësi për të tregtuar mbi ndryshimet në kurset e valutave, mallrave, indekset e tregut të aksioneve ose çmimet e aksioneve të quajtura instrumenti themelor.
- f) Vlera e instrumenteve financiare ndikohet drejtpërdrejt nga çmimi i asetit financiar ose ndonjë aset tjetër themelor që është objekt i përvetësimit.
- g) Klienti nuk duhet të blejë Instrumente Financiare përveç nëse ai / ajo është i gatshëm të ndërmarrë rreziqet e humbjes së një pjese të konsiderueshme të parave që ai / ajo ka investuar dhe gjithashtu çdo komision shtesë dhe shpenzime të tjera të shkaktuara.

Kufizimet Rregulatore Lokale

Uebfaqja e BKT dhe informacionet që lidhen me platformën Smart-Invest mund të qasen në të gjithë botën. Informacioni i ofruar në këto Publikime megjithatë ka për qëllim vetëm për t'u përdorur nga perdoruesit e vendosur në Kosovë, ku përdorimi i tillë nuk përbën shkelje të legjislacionit ose rregulloreve në fuqi. Asnjë nga produktet dhe shërbimet e përmendura në Publikimet e BKT nuk janë në dispozicion për marrësit që banojnë në vendet ku ofrimi i produkteve dhe shërbimeve të tilla mund të përbëjë shkelje të legjislacionit ose rregulloreve të detyrueshme vendore të zbatueshme.

Klienti që kërkon një produkt ose shërbim të BKT do të ketë përgjegjësi të veprave të perputhjes me legjislacionin ose rregulloren në fuqi.

Tarifat dhe Taksat

- a) BKT përmes platformës Smart-Invest ose ndonjë shërbimi tjetër on-line ka të drejtë të pranoj tarifa nga Klienti për shërbimet e tij, të përshkruara në këtë Njoftim, si dhe kompensim për shpenzimet që do të bëjë për detyrimet që do të ndërmarrë gjatë ekzekutimit të shërbimeve të përmendura. BKT rezervon të drejtën të modifikojë, herë pas here, madhësinë, shumat dhe përqindjet e tarifave të tij/saj dhe modifikimet e tilla do të publikohen në uebfaqen kryesore të BKT në dispozicion dhe publike për të gjithë klientët e saj.
- b) Të gjitha produktet financiare të ofruara në platformën Smart-Invest nuk janë produkte që ofrojnë ndonjë të ardhur nga interesi për Klientin. Si rrjedhojë, të gjitha fitimet e përfituara nga blerja / shitja e produkteve financiare në platformën Smart-Invest duhet të raportohen nga Klienti në deklaratën e të ardhurave të tyre personale dhe është përgjegjësia e vetë Klientit të raportojë ato fitime.
- c) Klienti do të paguajë menjëherë BKT, atëherë kur kërkohet nga kjo e fundit dhe BKT ka të drejtë të debitojë llogarinë e Klientit me çdo lloj tatimi që lidhet me aktivitetet e Klientit në platformën Smart-Invest, kontribut ose tarifë që mund të paguhet si një rezultat i çdo transaksioni që ka të bëjë me Klientin ose ndonjë veprim i BKT e përcaktuar sipas Marrëveshjes, nese nenshkrueshet.